



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec
RAHOVEC / ORAHOVAC



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/99 Nr. i faq./Br.str./No.pg 83

Data/Date/Date 26 / 02 / 2026

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17 shkronja f) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.6 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 25.02.2026 miraton këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale "KRM Ekoregjioni" në Rahovec

1. Me këtë vendim **formohet** Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale "KRM Ekoregjioni" në Rahovec, në këtë përbërje:
 - 1.1. **Florida Bajraktari**, e emëruar nga Kuvendi i Komunës, anëtare - AAK;
 - 1.2. **Flutura Thaqi**, e emëruar nga Kuvendi i Komunës, anëtare - PDK;
 - 1.3. **Përparim Krasniqi**, i emëruar nga Kryetari i Komunës, anëtar;
2. Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësit e komisionit sipas pikës 1 të këtij vendimi janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 31/2008") dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012"), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, lidhur me Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 9/2018") dhe aktet tjera nënligjore që janë në fuqi.
3. Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€ (pesëdhjetë euro) për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë dhe pagesa bëhet nga buxheti i Komunës së Rahovecit.
4. Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhen më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.
5. Komisioni Komunal i Aksionarëve i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të raportojë Kuvendit të Komunës së Rahovecit në bazë vjetore mbi performancën, përgjegjësitë dhe arritjen e objektivave të Ndërmarrjes Publike Lokale "KRM Ekoregjioni" në Rahovec.
6. Mandat i anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Rahovec, nëse ky mandat nuk përfundon më herët.
7. Kuvendi i Komunës në Rahovec e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.

8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetari të Komunës,*
- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *NPL “KRM Ekoregjioni” në Rahovec,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01Nr.99/26
Datë: 25.02.2026

